



## RELACION TEKNIK

### OBJEKTI:

**“MIREMBAJTJE E RRUGES ZHULAT”**

Punoi:

Ing. Aleksandri Pesha


Ing. Farold Mene

Ark. Nelson Sejdo

## 1. Te pergjithshme


Objekti ndodhet ne Bashkine e Gjirokastres. Ka nje gjatesi rreth 3.135 km qe te con ne fshatin Zhulat, eshtë fshat në jug të Shqipërisë në pjesën perëndimore të aksit Tepelenë-Gjirokastër, shtrihet në gjerësi geografike  $40^{\circ}07'11''$  veri dhe gjatësi  $19^{\circ}59'20''$  lindje. Ky fshat I përketë njësisë administrative Cepo.


*Pozicioni i objektit*



## II Foto te gjendjes ekzistuese







**Gjendja e shtresave ekzistuese.**

### **Gjendja e shtresave ekzistuese.**

Per hartimin e raportit teknik, se pari eshte bere vizitat ne terren, jane shkelur dhe kontrolluar te gjithe elementet e rruges si: analiza e gjendjes, sistemi i drenazhimit, shtresat ekzistuese, veprat e artit,etj.

Ky aks rruget eshte i paasfaltuar dhe aktualisht gjendja teknike e rruges eshte jo e mire.

Ndërhyrja parashikon mirembajtje te pjeshme te rruges, mbrojtje lumore me popla me peshe me te madhe se 500 kg, ndertimin e nje tombino dhe muri mbajtes ne km 0+800 nga hyrja e fshatit Zhulat, sistemimin me beton me gjeresi mesatare 4.2m te rruges ne pjeset e saja me te veshtira gjate periudhes te dimrit dhe ndertimin e bankinave ne kete pjesa rruge me gjeresi mesatare 0.5m.

Theksojme faktin se keto jane punime emergjente mirembajtje qe aksi rruogr te jetë funksional për periudhën e dimrit , dhe ndërhyet në pjesën nga Qëndra e fshatit Zhulat deri në afërsi të investimit të parashikuar nga Bashkia.

### **III. Përshkrinimi teknik i punimeve.**

#### **Zona I** e ndërhyrjes nga hyrja e fshatit Zhulat deri në km 0+800.

Përfshin shtresë betoni me gjëresi mesatare 4.2 m dhe gjatësi 800m, me trashësi 12 cm i armuar me zgare hekuri me peshë minimale 1.7 km/m<sup>2</sup> dhe e vendosur mbi shtresë zhavori h =10 cm.

Gjithashtu parashikohet dhe pastrimi i kanalit rehabilitimi i bankinave.

Kjo zonë gjatë periudhes te dimirit për shkak dhe të pjërësië të madhe bëhet e pa kalueshme.

#### **Zone II** e ndërhyrjes është në Km 0+800.

Përfshin rehabilitimin total të tombinos në këtë vend, ndërtimin e nje muri mbajtës me gjatësi 10 m dhe me lartësi 6 m..

#### **Zona III** e ndërhyrjes është në km 2+000 duke u nisur nga hyrja e fshatit Zhulat.

Përfshin shtresë betoni me gjëresi mesatare 4.2 m dhe gjatësi 50 m, me trashësi 12 cm i armuar me zgare hekuri me peshë minimale 1.7 km/m<sup>2</sup> dhe e vendosur mbi shtresë zhavori h =10 cm.

Gjithashtu parashikohet dhe pastrimi i kanalit rehabilitimi i bankinave me gjëresi mesatrare 0.5 m.

Kjo zonë gjatë periudhes te dimirit për shkak dhe të pjërësië të madhe bëhet e pa kalueshme.

#### **Zona IV** e ndërhyrjes është në KM 2+300- 2+400 duke u nisur nga hyrja e fshatit Zhulat.

Përshin mbrojtje lumore në dy segmente nga 50 ml duke e mbushur më formacionë shkëmborë popla me peshë minimale 500 kg me gjëresi 5 m dhe lartësi 2 m.

Kjo ndërhyrje është parashikur për të evituar gërryerjen e mëtejshmë të rrugës deri në një zgjidhje përfundimtare.

Ndërhyrja në këtë segment është emergjente pasi rrezikohet bllokimi total i qarkullimit në këtë aks rrugor

**Zona V** e ndërhyrjes është në km 2+600-2+750 duke u nisur nga hyrja e fshatit Zhulat.

Përfshin shtresë betoni me gjëresi mesatare 4.2 m dhe gjatësi 150 m, me trashësi 12 cm i armuar me zgare hekuri me peshë minimale 1.7 km/m<sup>2</sup> dhe e vendosur mbi shtresë zhavori  $h = 10$  cm. Gjithashtu parashikohet dhe pastrimi i kanalit rehabilitimi i bankinave me gjerësi mesatrare 0.5 m.

Kjo zonë gjatë periudhes te dimirit për shkak dhe të pjërësië të madhe bëhet e pa kalueshme.

Gjithashtu janë parashikuar dhe punime të mirëmbajtjes të përgjithshme si pastrim bari për të krijuar mundësinë e zgjerimit të rrugës, pastrimin e kanaleve të kullimit etj.